



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 515 Prot

Tiranë, më 13/4/2021

VENDIM

Nr. 23, datë 13.4.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 515 Prot., datë 16.03.2021, (saktësuar me shkresën nr. 515/1 Prot., datë 19.03.2021), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit nëpërmjet shkresës së datës 24.02.2021, depozituar në adresën elektronike të koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik [Liridona.Bodi@mfa.gov.al](mailto:Liridona.Bodi@mfa.gov.al), ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. Listën emërore të personave të cilët kanë qenë dhe janë të emëruar, për periudhën 2010-2021 (përsa është e aplikueshme), për të gjitha drejtoritë që janë në organigramën e institucionit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
2. Listën emërore e personave të cilët kanë qenë dhe janë të emëruar, për periudhën 2010-2021 (përsa është e aplikueshme), në pozicionet e mëposhtme (institucionet që janë në varësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme).

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit sipas shkresës nr. 515/1 Prot., datë 19.03.2021, në lidhje me pyetjen e parë të kërkesës, konkretisht, *listën e titullarëve/drejtorëve të çdo drejtorie brenda organigramës në ministri duke filluar nga viti 2010-2021 (për sa është e aplikueshme), por minimumi 3 vitet e fundit.*

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 515/2 prot., datë 24.03.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, brenda datës 31.03.2021.

Në tejkalim të afatit të përcaktuar, Autoriteti Publik me shkresën nr. 3695/1 Prot., datë 06.04.2021, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 515/3 Prot., datë 08.04.2021 ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: *“... Autoriteti Publik, pasi mori në shqyrtim kërkesën, bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në e-mail-in e datës 02.03.2021, ka kërkuar sqarim dhe saktësimin e kërkesës për informim në lidhje me pikën e dytë, pasi nuk përcaktoheshin pozicionet për të cilat u referohej. Në vijim në pamundësi të një saktësimi/sqarimi të kërkesës nga ana e kërkuarit, me shkresën nr. 515/2 Prot., datë 24.03.2021 të Komisionerit, vihemi në dijeni se kërkuari ka hequr dorë për pikën e dytë të kërkesës, konkretisht për shkakun për të cilën MEPJ kishte kërkuar qartësimin e saj. Gjithashtu, për sa më sipër Autoriteti Publik ka argumentuar se kemi të bëjmë me një ankesë të re nga ana e kërkuarit duke kërkuar listën e titullarëve/drejtorëve për periudhën 2010-2021, por minimumi 3-vitet e fundit dhe jo ankim ndaj kërkesës së parë, ku kërkonte listën e personave për të gjitha drejtoritë për periudhën 2010-2021. Për rrjedhojë, kërkon nga kërkuari ti drejtohet Autoritetit Publik me kërkesë të re sipas parashikimit të nenit 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në parim, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme*

dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e disponuar.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: “...kemi të bëjmë me një ankesë të re nga ana e kërkuarit duke kërkuar listën e titullarëve/drejtorëve për periudhën 2010-2021 (përsa është e aplikueshme), por minimumi 3-vitet e fundit”, Zyra e Komisionerit vlerëson se, argumenti i dhënë nuk qëndron. Në rastin konkret, ankuesi në kërkesën e datës 24.03.2021, për pikën e parë të saj, ka kërkuar “Listën emërore të personave të cilët kanë qenë dhe janë të emëruar, për periudhën 2010-2021 (përsa është e aplikueshme), për të gjitha drejtoritë që janë në organigramën e Autoritetit Publik”, ndërsa në ankesën e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për pikën e parë të kërkesës ka kërkuar “listën e titullarëve/drejtorëve të çdo drejtorie brenda organigramës në ministri duke filluar nga viti 2010-2021 (për sa është e aplikueshme), por minimumi 3 vitet e fundit”, ndërsa për pikën e dytë të saj është tërhequr. Pra, nga sa vërehet nuk kemi të bëjmë me një ankesë të re sipas argumentit të parashtruar nga Autoriteti Publik, por zvogëlim të objektit të kërimit, duke i qëndruar kërimit për 3 vitet e fundit.

Gjithashtu, bazuar në nenin 7, pika 1, shkronja d të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, informacioni i kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht dispozita e sipërcituar përcakton se: “Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet .... d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime”.

Nga sa më sipër, Autoriteti Publik jo vetëm duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, por në zbatim të nenit 7 të LDI, duhet që informacionin e kërkuar ta bëj publik në mënyrë proaktive në programin institucional të transparencës.

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka për qëllim të nxisë përforsimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 515 Prot., datë 16.03.2021, (saktësuar me shkresën nr. 515/1 Prot., datë 19.03.2021) të z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar sipas pikës 1 të kërkesës për informacion (listën e titullarëve/drejtorëve të çdo drejtorie brenda organigramës në ministri duke filluar nga viti 2010-2021 (për sa është e aplikueshme), por minimumi 3 vitet e fundit), brenda datës 21 . 4 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 13 . 4 .2021.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

